

Qeveria e Përkohshme e Shqipërisë :

Qeveria e Përkohshme e Shqipërisë ishte qeveria e parë krijuar nga Kuvendi i Vlorës me 4 dhjetor 1912. Krijimi i saj u vendos nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës, i cili me kërkesë të Ismail Qemalit e caktoi vetë përbërjen e qeverisë. Ismail Qemali, veç detyrës së kryetarit të qeverisë, mbajti edhe atë të Ministrisë të Jashtëm. Kuvendi zgjodhi edhe Pleqësinë, që funksiononte si organ këshillues e mbikëqyrës i qeverisë. Shumë krahina u bashkuan me Qeverinë e Përkohshme të Vlorës duke e njohur atë si qeveri të të gjithë Shqipërisë. Qeveria arriti rezultate të rëndësishme në krijimin e aparatit shtetëror dhe në krijimin e një sistemi gjyqësor sipas modeleve evropiane.

Qeveria e Vlorës pushoi së vepruari pasi, me mandatin e Fuqive të Mëdha, në territorin shqiptar filloi të ekzistojë Principata e Shqipërisë me kryeqytet Durrësin.

Përbërja e Qeverisë së Vlorës:

Ismail Qemali – Kryeministër dhe Ministër i Jashtëm

Qemal Karaosmani – Nënsekretar

Dom Nikollë Kaçorri/Prênk Bibë Doda – nënkryeministër

Myfit Libohova/Esat Toptani/Hasan Prishtina/Fejzi Alizoti – Ministër i Brendshëm

Gjeneral Mehmet Pashë Dërralla – Ministër i Luftës

Abdi Toptani/Aziz Vrioni/Gjergj Çako – Ministër i Financave

Dr.Petro Poga – Ministër i Drejtësisë

Dr.Luigi Gurakuqi – Ministër i Arsimit

Mit'hat Frashëri/Pandeli Cale – Ministër i Shërbimeve Publike (Botore)

Pandeli Cale/Hasan Prishtina/Qemal Karaosmani – Ministër i Bujqësisë

Lef Nosi – Ministër i Poste-Telegrafave